





SHKODËR
ORTOFOTO E PËRFTUAR NGJA IMAZHET SATELITORE

Publikimi në ArcGIS Online i Mbulesës së Tokës - Bashkia Tiranë

ASIG ka publikuar në ArcGIS Online WebMap-in me shtresën e Mbulesës së Tokës për Bashkinë Tiranë. Ky burim ofron të dhëna të sakta për planifikimin urban, zhvillimin e territorit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Harta dixhitale lehtëson analizën dhe identifikimin e zonave me potencial zhvillimi apo mbrojtje mjedisore, duke mbështetur vendimmarrjen institucionale dhe profesionale.



Zgjerimi i Hartës Bazë: Ish-Metalurgjiku, Elbasan



ASIG në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për temën "Harta Bazë", si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale për zonën e ish-Metalurgjikut, Elbasan. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rilevimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rilevuar prej 4.2 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rilevime fotogrametrike 3D arrin në 180.

Publikime në Gjeoportalin Kombëtar

Zonat Arkeologjike 'A' dhe 'B' të qytetit të Krujës

Bazuar në VKM nr. 204, datë 04.04.2025, janë shpallur si pasuri kulturore të paluajtshme zonat arkeologjike 'A' dhe 'B' të qytetit të Krujës. Në përputhje me planin e miratuar për ruajtjen dhe administrimin e tyre, janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar shtresat:

- Zonimi i Zonës Arkeologjike A dhe B;
- Kufiri i Zonës Arkeologjike A dhe B.



Ansambli Arkitektonik Urban i qytetit të Peshkopisë

Bazuar në VKM nr. 145, datë 06.03.2025, është shpallur pasuri kulturore e paluajtshme "Ansambli Arkitektonik Urban" i qytetit të Peshkopisë. Në Gjeoportalin Kombëtar janë publikuar shtresat:

- Zonimi i Ansamblit Arkitektonik Urban;
- Kufiri i Ansamblit Arkitektonik Urban;
- Zonimi i zonës mbrojtëse përreth ansamblit;
- Kufiri i zonës mbrojtëse.

Qendra Historike e fshatit Rabdisht, Peshkopi

Bazuar në VKM nr. 120, datë 26.02.2025, është shpallur pasuri kulturore e paluajtshme një zonë e identifikuar si "Qendër Historike" në fshatin Rabdisht, bashkia Dibër. Për këtë pasuri dhe zonën e saj mbrojtëse janë publikuar shtresat përkatëse:

- Zonimi i Qendrës Historike Rabdisht;
- Kufiri i Qendrës Historike Rabdisht;
- Zonimi i zonës mbrojtëse të Qendrës Historike;
- Kufiri i zonës mbrojtëse.



PJESËMARRJE NË AKTIVITETE

ASIG merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të EuroGeographics

Përfaqësues të ASIG morën pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të EuroGeographics, zhvilluar më 18–20 maj 2025 në Riga, të Letonisë. Aktiviteti mbledhi autoritete gjeohapësinore nga Europa, me fokus në transformimin digjital, inteligjencën artificiale dhe sigurinë institucionale.

Përmes pjesëmarrjes në diskutime strategjike, sesione shkëmbimi përvojash dhe vendimmarrjeje për prioritetet e ardhshme të organizatës, ASIG kontribuoi në proceset kryesore të bashkëpunimit evropian në fushën e informacionit gjeohapësinor. Kjo pjesëmarrje përforcon rolin e Shqipërisë në rrjetin evropian dhe mbështet zhvillimin e mëtejshëm institucional dhe profesional të sektorit.



Pjesëmarrja e ASIG në seminarin rajonal për Sistemin e Informacionit mbi Zjarret në Pyje dhe Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë



Përfaqësues të ASIG morën pjesë në seminarin rajonal të mbajtur në Prizren më 12–15 maj 2025, në kuadër të projektit për “Ndërtimin e kapaciteteve për Sistemin Kombëtar të Informacionit për Zjarret në Pyje (National Forest Fire Information System – NFFIS) dhe Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë”, i mbështetur nga JICA dhe AKMC.

Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilët ndanë përvoja mbi përdorimin e platformave digjitale dhe ndërhyrjet ekologjike për reduktimin e rrezikut nga zjarret dhe erozioni. Seminari theksoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe zgjidhjeve të qëndrueshme.

BOTA E GJEONFORMACIONIT

Evropa teston lidhjen 5G nga hapësira - Bashkëpunim mes ESA dhe CTO

Agjencia Evropiane e Hapësirës (European Space Agency – ESA) dhe kompania Constellation Technologies & Operations (CTO) do të realizojnë në qershor 2025 një test eksperimental me një pajisje inteligjente satelitore të ndërtuar në Evropë për transmetim 5G në spektrin mmWave. Pajisja synon të demonstrojë aftësinë për të ofruar lidhje hibride me shpejtësi të lartë dhe reagim të menjëhershëm ndërmjet rrjeteve tokësore dhe atyre satelitore. Ky bashkëpunim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së autonomisë teknologjike evropiane në fushën e komunikimit nga hapësira. Projekti synon të ofrojë një alternativë evropiane për lidhje të qëndrueshme, të shpejta dhe efikase nga hapësira.

Të dhënat globale tashmë të disponueshme në Ekosistemin e Hapësirës së të Dhënave Copernicus

Të dhënat globale të Shërbimit të Monitorimit të Tokës Copernicus (Copernicus Land Monitoring Service – CLMS), të prodhuara më parë nën Komponentin Global të Tokës, janë migruar me sukses në Ekosistemin e Hapësirës së të Dhënave Copernicus (Copernicus Data Space Ecosystem – CDSE), një platformë cloud moderne që ofron akses të përmirësuar, përpunim të avancuar dhe analizë të të dhënave në shkallë globale. Përdoruesit në mbarë botën mund të përfitojnë nga të dhëna të lira dhe të besueshme mbi mbulesën e tokës, indekset e vegjetacionit dhe dinamika e ujërave sipërfaqësore, të dhëna thelbësore për monitorimin e ndryshimeve mjedisore dhe për vendimmarrje të informuar në nivel global dhe rajonal. CDSE përmirëson ndjeshëm ndërpërprueshmërinë dhe përdorshmërinë e të dhënave, duke mbështetur vendimmarrjen shkencore dhe politike për zhvillim të qëndrueshëm në shkallë globale.

AKTIVITETE NË VIJIM

QGIS User Conference 2025

Konferenca vjetore e QGIS do të mbahet më 2-3 qershor 2025 në Norrköping, Suedi, duke ofruar një platformë për ekspertë dhe profesionistë të fushës së gjeoinformacionit. Ky aktivitet ka për qëllim prezantimin e zhvillimeve më të fundit dhe shkëmbimin e njohurive mbi aplikimet inovative të QGIS në analizën dhe menaxhimin e të dhënave gjeohapësinore.

2 - 3 Qershor 2025

www.asig.gov.al

AGILE 2025

Shoqata e Laboratorëve të Informacionit Gjeografik në Evropë (AGILE) organizon nga 10–13 qershor 2025, në Dresden, të Gjermanisë, konferencën me temë “Shkenca e Gjeoinformacionit përballë sfidave globale”. Aktiviteti do të mbledhë studiues dhe profesionistë nga Evropa dhe më gjerë për të prezantuar kërkime shkencore dhe zgjidhje inovative në fushën e gjeoinformacionit dhe vendimmarrjes së bazuar në të dhëna hapësinore.

10 -13 Qershor 2025

FOSS4G Europe 2025

Konferenca Evropiane FOSS4G do të zhvillohet nga 14–20 korrik 2025 në Mostar, të Bosnjë-Hercegovinës. Aktiviteti do të mbledhë profesionistë, studiues dhe studentë nga fusha e gjeoinformacionit për të ndarë njohuri, përvoja dhe zgjidhje inovative në përdorimin e teknologjive të hapura për hartografi, analiza hapësinore dhe planifikim.

14 -20 Korrik 2025

www.geoportal.asig.gov.al